



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 159, Datë 31.07.2024

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 15, DATË 31.01.2019 “MBI LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR, TË TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA, E RREGJISTRUAR PRANË QKB, SI DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ AKSIONARE (SH.A.), TRANS ADRIATIC PIPELINE AG”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 4, pika 50, 35, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 3, pika 1, gërma “a”, 53, pika 2 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.07.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1683/1 prot., datë 30.07.2024, të drejtorive teknike të ERE-s “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline Ag Albania, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG”, i ndryshuar”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendim nr. 15, datë 31.01.2019, “Mbi licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, të Trans Adriatic Pipeline Ag Albania, e rregjistruar pranë QKB, si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), Trans Adriatic Pipeline AG”, i ndryshuar me vendimin nr. 152, datë 13.06.2022, ndër të tjera ka vendosur: 2. Jo më vonë se data 01.07.2024, shoqëria të paraqesë në ERE dokumentacionin e plotë që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar në territorin e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”.
- Në kuadër të plotësimit të këtij kushti, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1683 prot., datë 26.07.2024, shoqëria ka informuar se ka përfunduar procesin e regjistrimit të të drejtave të tokave të blera dhe servitutit, si për korridorin e tubacionit të gazsjellësit, ashtu edhe për objektet mbitokësore (stacioni i kompresorëve, stacioni matës dhe stacionet e valvulave bllokuese).

- Po ashtu shoqëria bën me dije se në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 116/2013 “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”, dhe kuadrit ligjor për shpronësimin, këto të drejta janë regjistruar në emër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, përfshirë dhe të drejtat mbi tokën shtetërore të siguruara nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave.
- Shoqëria argumenton se sipas dispozitave të Marrëveshjes, pronësia dhe të drejtat e servitutit, të siguruara nga procesi i shpronësimit, duhet të transferohen në emër të TAP, në përputhje me Shtojcën 1, Pjesa 1, paragrafët (h) dhe (i) të kësaj marrëveshjeje. Ky proces është i mundur vetëm nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe për këtë shoqëria ka depozituar në ERE kërkesën zyrtare të datës 07.06.2024 drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës lidhur me këtë proces, ku ka kërkuar bashkëpunimin e këtyre institucioneve, si institucione përgjegjëse por dhe të specializuara në këtë fushë, në sigurimin e pronave dhe konsolidimin e të drejtave pronësore të ndikuara nga gazsjellësi TAP. Për sa më sipër, shoqëria ka bërë me dije se është në pritje të përgjigjes lidhur me këtë proces.
- Po ashtu, shoqëria ka sqaruar, se ndryshimet që kanë ndodhur në procedurat që lidhen me kadastrën, të cilat tashmë kryhen vetëm nëpërmjet portalit e-Albania, kanë shkaktuar vonesa edhe në procesin e përfundimit të regjistrimit të godinave dhe ka theksuar se të gjitha këto procese po i ndjek me institucionet përkatëse në mënyrë të vazhdueshme.
- Për gjithë sa më sipër, shoqëria ka kërkuar nga ERE që të shtyjë afatin e përmbushjes së kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 15/2019, i ndryshuar, duke sqaruar se koha e nevojshme për të përgatitur dhe miratuar vendimet e qeverisë është një proces jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të TAP-it, e për këtë arsye ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për të miratuar një shtyrje të dytë për një periudhë 24-mujore, si në vendimin e mëparshëm.
- Për gjithë sa më sipër argumentuar e kërkuar nga shoqëria, duke marrë në konsideratë rëndësinë e projektit të gazsjellësit TAP, shtrirjen e madhe të tij dhe kompleksitetin në pajisjen me të gjithë dokumentacionin e kërkuar pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 15/2019, i ndryshuar, e po ashtu duke marrë në konsideratë përpjekjet e shoqërisë për t’u pajisur me këtë dokumentacion, sikurse dhe kërkesa drejtuar institucioneve përgjegjëse për bashkëpunim në këtë proces, dhe në referencë të përcaktimeve të nenit 53, pika 2 dhe nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vlerësojmë të arsyetuar kërkesën e shoqërisë për të shtyrë me 24 muaj afatin e plotësimit të këtij kushti, pra deri më 01.07.2026.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të ndryshojë pikën 2 të dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.01.2019, i ndryshuar, si vijon:
 2. *Jo më vonë se data 01.07.2026, shoqëria të paraqesë në ERE dokumentacionin e plotë që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar në territorin e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 107/2021 “Për bashkëqeverisjen”.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA” degë e shoqërisë së huaj dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI